



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SKRAPAR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

**NR. 127 Datë 14.12.2018**

**PËR**

**HEQJEN NGA FONDI PYJOR/KULLOSOR TË SIPËRFAQJES PREJ 98.96 HA PËR OBJEKTIN "MËLOVË" QË DO TË PËRDORËT NGA SHOQËRIA "MINING VENTURES ALBANIA" SH.P.K PËR KRYERJEN E AKTIVITETIT MINERAR PËR SHFRYTËZIMIN E MINERALIT GËLQEROR DEKORATIV.**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 54/e, ligjin nr.9385 datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" të ndryshuar, VKM nr.438 datë 08.06.2016, "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave Publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish Komunave /Bashkive", VKM nr.591 datë 09.10.2018 për disa ndryshime në vendimin nr.1353 datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik si dhe të kritereve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqjes e të vëllimit të fondit pyjor" të ndryshuar, VKM nr. 592 datë 09.10.2018 për disa ndryshime në vendimin nr.1374 datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor" të ndryshuar dhe në shkresën e MTM Nr.7111/2, date 06.12.2018 "Për dhënien e dakortësisë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor" . Këshilli Bashkisë pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Ndërmarrja e Shërbimit Ppyjor

**VENDOSI:**

Të miratojë kërkesën për vazhdimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor/kullosor të sipërfaqjes prej 98.96 ha për objektin "Mëlovë" që të përdoret nga shoqëria "Mining Ventures Albania" sh.p.k për kryerjen e aktivitetit minerar për shfrytëzimin e mineralit gëlqeror dekorativ.

Vendimi u miratua me 14 vota pro , vota kundër s'ka, vota abstenim s'ka .

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat



**KRYETARI KËSHILLIT  
PARTIZAN GORÇE**